



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 389/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Inspektorati i Tregut, me seli në Prishtinë, rr. “Muharrem Fejza”, kundër debitorit Subjekti Ekonomik “P...”, sh.p.k, me NUI, me seli Komuna e Malishevës, të përfaqësuar nga Naim Spahiu avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.368/20 të datës 22.09.2020 të Përmbartuesit Privat Rushit Hoxha, me seli në Prizren, jashtë seancës me datën 06.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Subjekti Ekonomik “P...”, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.368/20, të datës 22.09.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha.

II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.368/20, i datës 22.09.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha.

A r s y e t i m

Kreditori, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Inspektorati i Tregut ka parashtruar propozim për përmbartim kundër debitorit Subjekti Ekonomik “P...”, sh.p.k, me seli Komuna e Malishevës, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbartues – Aktvendimi Nr.4170 të datës 24.07.2020, i formës së prerë prej datës 17.09.2020 dhe i ekzekutueshëm prej datës 17.09.2020, me të cilën debitori është obliguar që kreditorit në emër të gjobës t’ia paguaj shumën prej 1,000.00€ (një mijë euro) në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit në xhirollogarinë Nr. të Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha, me seli në Prizren, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Inspektorati i Tregut, me datë 22.09.2020, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.368/20, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit

përmbaarues, Aktvendimit të Inspektoratit të Tregut Nr. 4170, të datës 24.07.2020 me të cilën është detyruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, t'ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumë prej 1,000.00 € (një mijë euro), si dhe shpenzimet e procedurës përmbaarimore me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare, dhe bartjen e shumë përkatëse në llogarinë e përmbaaruesit privat, si dhe regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit ashtu që të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Debitori Subjekti Ekonomik "P...", sh.p.k, përmes të autorizuarit të saj, avokatit Naim Spahiu, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me shkrim, për shkak të cenimit qenësor të rregullave të procedurës përmbaarimore, të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke theksuar se urdhri i lejuar nuk është i bazuar dhe nuk është i mbështetur në prova dhe është i palejueshëm për faktin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore në bazë të LPP-së, për arsye se aktvendimi nuk është pranuar nga ana e debitorit siç parashihet me ligj dhe se ndaj aktvendimit me nr. 4170 të datës 24.07.2020 është iniciuar konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente. Gjykatës i ka propozuar që të aprovet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të abroget urdhri përmbaarimor dhe të obligohet pala kreditori në pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbaarimore dhe atë për prapësim në shumë prej 104 euro.

Kreditori me përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke theksuar se urdhri i lejuar nuk përbën asnjë shkelje procedurale dhe se inspektorët e tregut kanë vepruar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe brenda kompetencave ligjore. Më tutje ka shtuar se debitorit i është shqiptuar gjoa pas inspektimit në subjektin ekonomik pasi që debitorit edhe pse i është dhënë mundësia që ta prezantoj dokumentin përkatës brenda afatit prej tridhjetë ditësh i njëjti nuk e ka prezantuar dokumentacionin e kërkuar. Më tutje ka shtuar se aktvendimi është pranuar dhe nënshkruar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit me datën 03.08.2020 duke respektuar procedurat ligjore, dhe se aktvendimi i përshkruar është dokument i besueshëm dhe shërben si dokument i përmbaarues dhe ekzekutiv. Ndërsa sa i përket padisë së ushtruar lidhur me këtë çështje, kreditori ka theksuar se është procedurë e ndarë dhe në rast se debitorit i aprovet padia atëhere i njëjti mund të i kthej mjetet në procedurën e kundër përmbaarimit, pasi që iniciimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e aktvendimit. Në fund i ka

propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të lejohet zhvillimi i procedurave të përbarimit konform ligjit në fuqi të procedurës përbarimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përbarimor, përkatësisht Vendimin Nr. 4170, në bazë të së cilit përbaruesi privat ka lejuar përbarimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përbarues sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se Vendimi Nr. 4170, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimin Nr. 4170, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmëris për përbarueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”,* ngase Aktvendimi Nr.4170 i datës 24.07.2020, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është bërë i formës së prerë me datë 17.09.2020 dhe i ekzekutueshëm me datë 17.09.2020.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përbarues mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës

përmbardimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbardimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbardimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e nenëve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së

Gjykata po ashtu i vlerësoi pretendimet e debitorit se lidhur me këtë çështje ka iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative mirëpo gjeti se vendimi Nr. 271/19 i datës 12.11.2019 përbën dokument përmbardimor konform nenit 24 par.3 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se “ *Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbardimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.*”, dhe bazuar në dispozitën e nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, me të cilën është përcaktuar se: “ *Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe*”, rezulton se paraqitja e padisë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbardimore dhe si rrjedhojë nuk e ndalon përmbardimin.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbardimore dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.389/22, datë 06.09.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,

nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë,

në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.